



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Beledijesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Giriş - Hyrëse - Ulazna - Incoming	
01	No.Nr. 02-24
Tarih/Dt. 31.01.2024	

01 Nr. 02 /24
Më 31.01.2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), neni 40 paragrafi 1 dhe 2 pika (e) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 82 i statutit të Komunës së Mamushës në mbledhjen e mbajtur me datën 31.01.2024 Kuvendi Komunal miratoi këtë:

Vendim

Për Themelimin e Komisionit dhe Emërimin e Anëtarëve të Komisionit Për Emërimin e Rugëve, Shesheve dhe Lagjeve të Komunës së Mamushës

NENI 1

Me këtë vendim themelohet Komisioni për emërimin e Rugëve, Shesheve dhe Lagjeve

NENI 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit janë në përputhje me Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, të shqyrtoj kërkesat dhe propozimet që do të marrë nga qytetarët për emërimin Rugëve, Shesheve dhe Lagjeve të caktuara

NENI 3

Komisioni për emërimin e Rugëve Shesheve dhe Lagjeve të Komunës së Mamushës do të ketë këtë përbërje.

- 3.1. Hatice Mazrek- Përfaqësuese nga Subjekti Politik KDTP
- 3.2. Fatma Morina- Përfaqësuese nga Subjekti Politik KATP
- 3.3. Erhan Mazrek- Përfaqësues nga Subjekti Politik- KATP
- 3.4. Halim Sadiku- Përfaqësues nga Subjekti Politik- PDK
- 3.5. Esra Osi- Përfaqësuese nga DPUGjK
- 3.6. Engin Taç- Përfaqësues nga DSHP
- 3.7. Gülhan Kruezi - Prërfaqësues nga DAKRS
- 3.8. Sina Taç - Përfaqësues nga DPUGjK
- 3.9. Rüstem Morina - Profesor

NENI 4

Nga mbledhja e parë anëtarët e emëruar si në pikën III të këtij vendimi me shumicë votash do ta zgjedhin Kryesuesin dhe Zëvendës-kryesuesin e grupit

NENI 5

Shërbimet administrativo-Teknike për punën e Komisionit do ti ofrojë ndihmë Drejtoria Për Planifikim, Urbanizëm dhe Gjeodezi Kadastër, si dhe Drejtorit të tjera gjegjëse.

NENI 6

Mandati i anëtarëve të Komisionit të emëruar sipas pikës III të këtij vendimi përfundon me përfundimin e mandatit aktual të anëtarëve të Kuvendit, apo me ndonjë vendim tjetër të Kuvendit të Komunës.

NENI 7

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Komisionit dhe Drejtoria Për Planifikim, Urbanizëm dhe Gjeodezi Kadastër

NENI 8

- I. Vendimi shpallet 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë Përgjegjëse dhe 7 ditë pas publikimit në wëp faqen e Komunës së Mamushës

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtoritë Komunale
- Qytetarët
- Arkivit

